

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6218  
E mërkurë, 20 janar 2021  
çmimi 0.40 €

Me  
kokrra  
gruri dhe  
fara,  
artisti  
shqiptar  
krijon  
portretin  
e Joe  
Bidenit



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ | FAQE 8-9

## DO TË BEFASOHENI ME REZULTATIN E AAK-së

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Pal Lekaj, beson se rezultati i AAK-së në zgjedhjet e 14 shkurtit do të jetë befaseshëm. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se në këto zgjedhje pret mbështetje të madhe si kurrë më parë për AAK-në. Lekaj ka thënë se kjo parti nuk merret shumë me sondazhe, por punon në terren me strukturat dhe elektoratin e saj. Sipas tij, në këto takime me qytetarë po vërehet disponim i lartë i tyre për ta mbështetur AAK-në



## SHPALLEN TË PAFAJSHËM TË AKUZUARIT NË RASTIN 'VETERANËT'

Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur të martën vendimin për rastin e njohur "Veteranët", duke i liruar nga akuza 12 persona të akuzuar për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Gjykata Themelore në Prishtinë ka njoftuar se ata janë liruar nga akuza pasi që "gjykata nuk ka gjetur prova se të njëjtët kanë kryer



veprën penale për të cilën janë akuzuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës" | FAQE 7



## LIMAJ FALËNDERON FAMILJET E DËSHMORËVE PËR MBËSHTETJEN

FAQE 6

### AKTUALE

EDHE NËNTË TË VDEKUR  
DHE 294 RASTE TË REJA  
ME COVID NË KOSOVË F. 3

QEVERIA E PRESIDENCA, PA  
KONSSENSUS PËR DREJTORIN E  
RI TË AKI-së F. 5

FILLON TRAJNIMI  
I GJENERATËS SË 56  
TË KADETËVE POLICORË F. 3



### EKONOMI

DOGANA ZBULON BARNË TË  
KONTRABANDUARA F. 8

PRODHIM REKORD NË HISTORINË  
E KEK-ut F. 8



### SPORT

SOT DERBI PEJA - RAHOVECI,  
NESËR YLLI - BASHKIMI F. 12

PRISHTINA MBAN SEANCËN  
E PARË STËRVITORE  
NË ANTALIA F. 12

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## BE-ja synon të vaksinojë 70 për qind të të rriturve deri në qershor



BRUKSEL, 19 JANAR - Bashkimi Evropian po synon të vaksinojë kundër Covidit 70 për qind të popullsisë së rritur deri në qershor, tha zëvendës-presidenti i Komisionit Evropian, Margaritis Schinas, të martën në një konferencë për media. Për planin janë pajtuar të gjithë komisionarët e BE-së. Blloku filloi vaksinimin tri javë më parë dhe deri më tani ka miratuar dy vaksina, atë nga "BioNTech/Pfizer" dhe atë të kompanisë "Moderna". Por,

ritmi i vaksinimit po zvarritet dhe qëndron pas vendeve të tilla si ShBA-ja, Britania e Madhe, Izraeli dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Komisionarja e Shëndetësisë, Stella Kyriakides, tha se në bazë të strategjisë së blerjes së përbashkët të BE-së, do të ketë doza të mjaftueshme për të vaksinuar 80 për qind të popullsisë së BE-së prej 450 milionësh. Ajo pranoi, megjithatë, se "procesi i vaksinimit duhet të përshpejtohet".

Ndërsa zëvendës-presidenti i Komisionit Evropian, Margaritis Schinas, tha se "deri në verë vendet anëtare duhet ta kenë vaksinuar një minimum prej 70 përqindësh të popullsisë së rritur". Ai tha se kjo duhet të ndodhë para 1 qershorit. Shefja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se përmbyshja e qëllimit prej 70-përqindësh, brenda katër muajve të ardhshëm mund të jetë "një pikë kthese në luftën tonë kundër këtij virusi".

## Bideni do t'i vazhdojë ndalesat në udhëtime, pavarësisht vendimit të Trumpit

NJU-JORK, 19 JANAR - Jen Psaki, zëdhënësjë e presidentit të zgjedhur amerikan Joe Biden, ka kundërshtuar një lajmërim të presidentit Donald Trump, se ndalesa për udhëtarët që nisen nga Evropa dhe Brazili drejt Shteteve të Bashkuara do të mund të hiqet. Kjo ndalesë ka nisur së aplikuari me qëllim të luftimit të koronavirusit.

Psaki, e cila do të shërbejë si sekretare për Media kur Bideni të nisë së udhëhequri ShBA-në, ka thënë në "Twitter" se "pas këshillimit me ekipin tonë mjekësor", administrata nuk synon ta heqë ndalesën. "Në fakt, ne planifikojmë t'i rrisim masat e shëndetit publik sa i përket udhëtimit, me qëllim të luftimit të mëtejshëm të përhapjes së Covid-19", ka shtuar ajo, duke i referuar virusit Covid.

Komentet e saj kanë ardhur pak pasi Trumpi ka pretenduar se mund t'i pezullojë ndalesat për udhëtarët nga Evropa, zona Shengen, Britania, Irlanda dhe Brazili. Në njoftimin e Trumpit është



përmendur edhe se ndalesat për udhëtarët nga Kina dhe Irani do të vazhdojnë të zbatohen. Qendra Amerikane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve ka

vendosur se nga 26 janari shumica e udhëtarëve që arrijnë në ShBA duhet ta prezantojnë testin negativ për Covid, apo të shfaqin dëshmi se janë shëruar nga ky virus.



## Me kokrra gruri e fara, artisti shqiptar krijon portretin e Joe Bidenit

PRISHTINË, 19 JANAR - Një artist nga Kosova ka krijuar portretin e presidentit të zgjedhur të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, duke përdorur kokrra gruri dhe fara. "Euronews" ka raportuar se Alkent Pozhegu përdori për realizimin e veprës plot 120 kilogramë grurë, misër, fasule, fara luledielli dhe oriz.

"Shpresoj që me kalimin e kohës të bëj diçka shumë më të madhe sepse Bideni e meriton. Ai ka qenë kontribuues i madh për ndërtimin e shtetit të Republikës së Kosovës", është shprehur artisti. Pozhegu punoi për ditë të tëra në Qendrën Kulturore të Gjakovës për ta përgatitur portretin me përmasa tri metra me 2.5 metra.

## Si pasojë e një stuhie të borës, 130 makina përplasen në një aksident në Japoni

TOKIO, 19 JANAR - Një stuhi gjigante dëbore është bërë shkas për aksidentin e rëndë rrugor në veri të Japonisë, ku 130 makina janë përplasur me njëra-tjetrën. Një person humbi jetën e dhjetë të tjerë mbetën të lënduar në autostradën e Tohokut në

prefekturën Miyagi, në të cilin u përfshinë rreth 200 veta. Ekipet e emergjencës mbërritën me shpejtësi në vendngjarje për ta ofruar ndihmën e parë. Japonia është përfshirë javët e fundit nga një i ftohtë i acartë dhe stuhitë e dëborës kanë

goditur disa pjesë të vendit, ku reshjet e saj kanë qenë thuajse dy herë më të larta se mesatarja e pritshme. Për shkak të dukshmërisë së ulët në rrugë, autoritetet japoneze kishin vendosur një kufi shpejtësie në rrugë prej 50 km në orë.



# Edhe nëntë të vdekur dhe 294 raste të reja me Covid në Kosovë



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar të martën se nga Covid-19 kanë vdekur edhe nëntë persona. Dy viktima janë shënuar në Prishtinë dhe nga një në Drenas, Gjakovë, Kamenicë, Mitrovicë, Prizren, Suharekë dhe Vushtrri. Bazuar në raportin ditor të IKShPK-së, janë testuar edhe 1 729 mostra të dyshuara, prej të cilave 294 kanë dalë pozitive me Covid. Të shëruar nga Covidi janë regjistruar edhe 281 pacientë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 JANAR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1

729 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 294 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar nëntë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të

vdekurve janë nga komunat: Prishtinë dy raste (68, 67 vjeç), Drenas një rast (63 vjeç), Gjakovë një rast (66 vjeç), Kamenicë një rast (85 vjeç), Mitrovicë një rast (68 vjeç), Prizren një rast (59 vjeç), Suharekë një rast (61 vjeç), Vushtrri një rast (69 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 56 412 nga 211 689 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 420 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 281 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 49 713 raste, kurse numri i rasteve aktive është 5 279.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 101 raste, Prizren 35 raste, Ferizaj 19 raste, Gjiilan 15 raste, Podujevë 15 raste, Suharekë 13 raste, Klinë 11 raste, Pejë 11 raste, Lipjan 9 raste, Gjakovë 7 raste, Malishevë 7 raste, Rahovec 7 raste, Fushë-Kosovë 6 raste, Shtime 6 raste, Dragash 5 raste, Kamenicë 5 raste, Kaçanik 5 raste, Viti 5 raste, Drenas 3 raste, Mitrovicë 3 raste, Deçan 2 raste, Skenderaj 2 raste dhe me nga një rast komunat Junik dhe Vushtrri.

## Komunat furnizohen me frigoriferë mobilë

Prishtinë, 19 janar (ER) - Në kuadër të bashkëpunimit me Programin e Zgjeruar të Imunizimit, UNICEF-i për ekipet e imunizimit, për të gjitha komunat, të martën ka dhuruar 1 394 frigoriferë mobilë. Ministri në detyrë i

Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se donacioni është përkrahur nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar dhe i kontribuon efikasitetit dhe sigurisë së imunizimit dhe për këtë i falënderojmë sinqerisht.

“Kapaciteti i ruajtjes së vaksinave është 2.6 litra, deri në 41 orë 29 minuta, kohë e mjaftueshme për ekipet mobile të imunizimit për të vepruar në tërë territorin e shtetit, me siguri të plotë”, ka thënë Zemaj.



## Fillon trajnimi i gjeneratës së 56 të kadetëve policorë



PRISHTINË, 19 JANAR (ER) - Në ambientet e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP) ka filluar trajnimi i gjeneratës së 56, ku 207 kadetë policorë të Policisë së Kosovës kanë nënshkruar kontratën. Kadetëve të rinj mirëseardhje u dëshiroi stafi menaxhues nga Divizioni i Trajnimit të Policisë së Kosovës së bashku me instruktorë policorë, njëkohësisht u dëshiruan suksese dhe i inkurajuan të angazhohen maksimalisht për marrjen e njohurive teorike dhe praktike në mënyrë që këto

njohuri të fituara t'i zbatojnë pas fillimit të punës në stacione policore.

Përmes këtij trajnimi kadetët policorë marrin njohuritë e nevojshme sipas standardeve më të larta evropiane për t'i kryer detyrat me profesionalizëm në shërbim të qytetarëve. Policia e Kosovës në bashkëpunim me AKSP-në do t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që përcaktojnë rregullat e IKShPK-së për mbajtjen e trajnimit/mësimin, gjatë kësaj situatë të pandemisë.



FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ

## Do të befasoheni me rezultatin e AAK-së

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Pal Lekaj, beson se rezultati i AAK-së në zgjedhjet e 14 shkurtit do të jetë befasues. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se në këto zgjedhje pret mbështetje të madhe si kurrë më parë për AAK-në. Lekaj ka thënë se kjo parti nuk merret shumë me sondazhe, por punon në terren me strukturat dhe elektoratin e saj. Sipas tij, në këto takime me qytetarë po vërehet disponim i lartë i tyre për ta mbështetur AAK-në

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 19 JANAR - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Pal Lekaj, ka bërë me dije se kjo parti do të marrë rezultat të mirë në zgjedhjet e përgjithshme të 14 shkurtit. Ai ka thënë se strukturat e AAK-së janë angazhuar maksimalisht dhe presin mbështetje të madhe të qytetarëve të Kosovës në këto zgjedhje.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Lekaj ka paralajmëruar se rezultati i këtij subjekti politik do të jetë befas. "Presim mbështetje masive si kurrë më parë në këto zgjedhje. Nuk merremi shumë me sondazhe. Ne jemi duke vazhduar punën në terren dhe besoj se do të befasoheni nga rezultati që do të korrë AAK-ja

më 14 shkurt", ka thënë Lekaj. Ai ka treguar se nga takimet në terren, që kanë me strukturat dhe elektoratin e AAK-së, vërehet disponim i lartë i qytetarëve për ta mbështetur këtë subjekt politik. "AAK-ja gjithmonë qëndron në terren, pranë strukturave të veta dhe është më se normale që zgjedhjet e motivojnë edhe më shumë, prandaj vërehet disponim shumë i lartë për ta mbështetur Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës dhe kandidimin e Ramush Haradinajt për president", ka deklaruar Lekaj.

Më tej, nënkryetari i AAK-së ka përmendur edhe arsyet pse qytetarët duhet ta votojnë këtë subjekt politik. "Programi i AAK-së në këto zgjedhje përmban aspektin ekonomik të rimëkëmbjes që është duke lënguar nga pasojat e Covid-19

dhe aspektin politik të prosperitetit dhe avancimit të Kosovës në rrugën euroatlantike. Këto janë dy arsyet kryesore që votuesit duhet ta votojnë AAK-në", ka thënë Lekaj.

Ai ka folur edhe për akuzat e AAK-së ndaj PDK-së për vjedhje të programit. "Hartuesit e programit ekonomik të AAK-së kanë vërejtur se PDK-ja ka marrë pjesë të programit tonë për rimëkëmbje ekonomike, në veçanti fondit një miliardësh që do të jetë infuzion për bizneset e Kosovës", është shprehur Lekaj.

**"Epoka e re":** Z. Lekaj, prej shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme, AAK-ja ka filluar aktivitetet në terren. Nga këto takime, cili është disponimi i qytetarëve për zgjedhje?

**Lekaj:** AAK-ja gjithmonë

qëndron në terren pranë strukturave të veta dhe është më se normale që zgjedhjet i motivojnë edhe më shumë dhe këtë herë vërehet disponim shumë i lartë për ta mbështetur Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës dhe kandidimin e Ramush Haradinajt për president.

**"Epoka e re":** Çfarë përmban programi i AAK-së në këto zgjedhje? Pse duhet ta votojnë AAK-në qytetarët?

**Lekaj:** Programi i AAK-së në këto zgjedhje përmban aspektin ekonomik të rimëkëmbjes që është duke lënguar nga pasojat e Covid-19, edhe në aspektin politik të prosperitetit dhe avancimit të Kosovës në rrugën euroatlantike. Këto janë dy arsyet kryesore që votuesit duhet ta votojnë AAK-në.

**"Epoka e re":** E keni akuzuar PDK-në se jua ka vjedhur programin. Cilat pjesë të programit pretendoni se jua ka vjedhur kjo parti?

**Lekaj:** Hartuesit e programit ekonomik të AAK-së kanë vërejtur se PDK-ja ka marrë pjesë të programit tonë për rimëkëmbje ekonomike, në

veçanti të fondit një miliardësh që do të jetë infuzion për bizneset e Kosovës.

**"Epoka e re":** Kësaj radhe AAK-ja nuk ka kandidat për kryeministër, por kandidat për president. Pse vendoset kështu?

**Lekaj:** Të mos harrojmë se që nga viti 2008 kur Kosova shpalli pavarësinë, Kuvendi i Kosovës nuk ka zgjedhur tri institucionet themelore të shtetit përnjëherë. Pra, në zgjedhjet e 14 shkurtit do të formohen tri institucionet kyçe: Kuvendi, Qeveria dhe Presidenca. Për këto rrethana të krijuara AAK-ja këtë herë garon në këto zgjedhje për Ramush Haradinajt president që do të jetë garantues i Kushtetutës dhe unitetit të popullit.

**"Epoka e re":** Cilat janë pritjet tuaja për këto zgjedhje? Sa për qind mendoni se do t'i fitoni, sepse disa sondazhet nuk e nxjerrin AAK-në mirë?

**Lekaj:** Presim mbështetje masive si kurrë më parë në këto zgjedhje. Nuk merremi shumë me sondazhe. Ne jemi duke vazhduar punën e palodhur në terren. Besoj se do të befasoheni nga rezultati që do të korrë AAK-ja më 14 shkurt.

# Qeveria dhe Presidenca, pa konsensus për drejtorin e ri të AKI-së

Prishtinë, 19 janar - Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, ende nuk i është përgjigjur propozimit të kryeministrit në detyrë, Avdullah Hoti, për emërimin e drejtorit të ri të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI), të cilin ai e kishte dërguar para tre javësh. Ky post mbeti i lirë prejse Kreshnik Gashi liroi detyrën me kërkesë të kryeministrit në detyrë, Hoti. Kërkesa e Hotit ishte mbështetur edhe nga u.d e presidentit, Osmani.

Në presidencë dhe qeveri nuk konfirmojnë nëse kanë komunikim institucional për ta zgjedhur drejtorin e ri të AKI-së, ashtu siç parashihet në ligj.

Bazuar në Ligjin për AKI-në, në nenin 5.3 përcaktohet se "presidenti i Republikës së Kosovës, së bashku me kryeministrin, emërojnë së bashku drejtorin e AKI-së brenda 20 ditësh pune nga dita kur pozita mbetet e lirë".

Gashit i ishte kërkuar ta lironte pozitën më 17 dhjetor 2020, por asnjëherë nuk janë dhënë detaje zyrtare për datën e saktë

kur ai e ka liruar këtë pozitë.

Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, kishte deklaruar për mediat vendore në fund të vitit 2020, se "ka dërguar në Presidencë propozimin e tij për drejtorin e ri të AKI-së". Burime të "Radion Evropa e Lirë" konfirmojnë se propozimi i kryeministrit është një "personalitet që ka shërbyer në AKI, e që madje ka pasur edhe pozitë brenda këtij institucioni". Të njëjtat burime theksojnë se Hoti ka ofruar edhe një emër të dy, por deri më tani nuk ka marrë përgjigje nga Osmani.

Në Presidencë insistojnë se janë brenda afatit ligjor. "Ende jemi në afatin kohor ligjor për emërimin e shefit të ri të AKI-së", tha në një përgjigje të shkurtër për "Radion Evropa e Lirë", Bekim Kupina, këshilltar për media i ushtrueses së detyrës i presidentit, Vjosa Osmani.

Ai shtoi se "u. d. e presidentit Osmani do ta bëjë propozimin e saj siç e parashohin ligji dhe Kushtetuta e Kosovës", pa dhënë detaje nëse kjo

nënkupton një emër të ri nga ai që i është propozuar nga kryeministri në detyrë, Hoti.

Antigona Baxhaku, këshilltare politike e kryeministrit në detyrë, Hoti, tha për "Radion Evropa e Lirë" se në pikëpamjen e qeverisë, "u. d. e presidentit, Vjosa Osmani, ka të drejtë që të ketë propozimin e saj për drejtorin e ri të AKI-së, pasi kjo përcaktohet me ligj. Megjithatë, vendimi final nuk mund të merret pa pajtueshmëri ndërmjet u. d. presidentit dhe kryeministrit në detyrë", ka thënë Baxhaku.

Nëse merret për bazë, data e kërkesës së kryeministrit në detyrë, drejtuar ish-drejtorit të AKI-së, Kreshnik Gashi, drejtori i ri i AKI-së duhet të emërohet më së largu brenda kësaj jave.

Eksperti i çështjeve të sigurisë, Agim Musliu, thotë për Radion Evropa e Lirë se klasa politike duhet të jetë e vëmendshme dhe e përmbajtur kur përfshihet në ndërrimin e udhëheqësve të segmenteve të sigurisë, veçmas shërbimit sekret. "Për aq sa politika i fut duart në segmentin e sigurisë,

aq më shumë do të kemi devijim. Kjo do ta bëjë jofunksionale segmentin e sigurisë, përfshirë këtu AKI-në, por edhe policinë dhe ushtrinë apo shërbimet emergjente e të tjera", ka thënë Musliu.

Ai e sheh të rëndësishme që në këtë pozitë të mos emërohen njerëz politikë, por ata që janë dëshmuar në fushën e sigurisë. "Është mendim imi personal se në këtë pozitë duhet të emërohet dikush që ka zhvilluar aktivitet profesional ose që ka dhënë kontribut në fushën e sigurisë. Është e rëndësishme që të jetë i familjarizuar me sfidat e segmentit të sigurisë dhe të ketë përvojë adekuate", vlerëson Musliu. Sipas tij, Ligji për AKI-në duhet të amendamentohet. "Autorizimet e këtij shërbimi duhet të rriten dhe të shkojnë përtej kësaj kornize që është tash", shton Musliu.

Ai vlerëson se ndërrimi kaq i shpeshtë i drejtuesve të AKI-së shkakton huti e pasiguri edhe brenda vetëm shërbimit sekret të vendit. Drejtori i fundit i

shkarkuar i AKI-së, Kreshnik Gashi, ishte emëruar në këtë pozitë më 25 nëntor të vitit 2019, nga ish-kryeministri Ramush Haradinaj dhe ish-presidenti Hashim Thaçi.

Paraprakisht, Kreshnik Gashi ka mbajtur pozitën e kryetarit të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës. Ai është emëruar në krye të AKI-së, pas dorëheqjes së Shpend Maxhunit më 2019.

Më 2017 edhe Agron Selimaj kishte dhënë dorëheqje nga udhëheqja e AKI-së. Ndërkaq, më 2015, dorëheqje nga kreu i AKI-së pati dhënë edhe Bashkim Smakaj.

AKI-ja është agjenci për siguri dhe inteligjencë, e cila, sipas ligjit, "analizon dhe shpërndan produkte inteligjente në mënyrë të shpejtë, të ligjshme dhe të përgjegjshme te presidenti, kryeministri dhe institucionet e tjera kompetente".

Drejtori i AKI-së, i cili emërohet për një mandat pesëvjeçar me mundësi vazhdimi, i përgjigjet drejtpërdrejt kryeministrit.



# Hoxhaj në Vushtrri: Fondi 1 miliard do ta rimëkëmbë sektorin privat të prekur nga pandemia

PRISHTINË, 19 JANAR (ER) - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka vizituar të martën disa biznese prodhuese vendore në Komunën e Vushtrrisë, të cilave u ka premtuar se qeveria e udhëhequr nga ai do të jetë partnere e tyre. Për t'i përballur efektet negative të pandemisë në sektorin privat, Hoxhaj ka theksuar se ekipi i rimëkëmbjes ka dizajnuar fondin 1 miliard eurosh, ku 500 milionë janë të dedikuara për biznesin dhe ndërmarrësinë e Kosovës, ndihmë direkte dhe pa kthim. Këto mesazhe, Hoxhaj, i shoqëruar nga nënkryetari Bedri Hamza, i ka dhënë gjatë vizitave në kompanitë e njohura "Vipa", "Albed" dhe "Missini". "Ne jemi të vendosur që ta zhvillojmë sektorin privat se nuk ka sektor tjetër, i cili mund të krijojë vende të reja të punës i cili mund ta rritë ekonominë e vendit. Ne nuk mund ta rrisim territorin, por mund ta rrisim ekonominë e vendit. Nuk ka sektor i cili mund ta rritë mirëqenien e qytetarëve sikurse sektori privat dhe ky do të jetë prioriteti kryesor i qeverisë të cilën do ta

udhëheq unë si kryeministër i Kosovës. Natyrisht që ne jemi partnerë të biznesit në Kosovë dhe do të ofrojmë mbështetje institucionale, do të ofrojmë mbështetje përmes politikave konkrete fiskale, lehtësira fiskale dhe do të jemi partnerë të tyre që këtë punë të madhe që këta po e bëjnë edhe t'u ndihmojmë që t'i eksportojmë produktet e tyre jashtë, po të jenë edhe një lloj imazhi i ri, një lloj brendi i ri i një Kosove të re, e cila po ndërtohet çdo ditë nga ndërmarrës të suksesshëm", ka thënë ai.

Plani i rimëkëmbjes së PDK-së parasheh që në tatimin në të ardhura të korporatave, të gjithë investitorët do të kenë stimulime të ndryshme, të cilat u mirëpritën nga përfaqësuesit e bizneseve. Sipas planit të PDK-së për rimëkëmbje, në investimet mbi 100 000 euro, që krijojnë mbi pesë vende të punës, tatimi në të ardhura të korporatës do të jetë 8 për qind, derisa në investimet prej 500 000 deri në 1 milion euro, që krijojnë mbi 8 vende të punës, tatimi në të ardhura të korporatës do të jetë 7 për qind për 10 vjet. Ky plan parasheh që në investime prej



1 milion deri në 3 milionë euro, që krijojnë mbi 20 vende të punës, tatimi në të ardhura të korporatës do të jetë 5 për qind për 10 vjet, si dhe në investimet mbi 3 milionë euro, që krijojnë mbi 30 vende të punës, tatimi në të ardhura të korporatës do të jetë 0 për qind për 10 vjet.

Në këto takime Hoxhaj dhe Hamza kanë njoftuar prodhuesit që me qeverisjen e PDK-së tatimi doganor do t'u kthehet të gjithë prodhuesve me rastin e eksportit në qoftë se për mallin, i cili ka marrë pjesë në prodhim, është paguar tatimi doganor me rastin e importit. Në fund ata

kanë theksuar se tatimi i akcizës do t'u kthehet të gjithë prodhuesve me rastin e eksportit në qoftë se me rastin e prodhimit ndonjë mall ka marrë pjesë në proces të prodhimit për të cilin është paguar akciza qoftë në brendi të vendit ose me rastin e importit.

## Hoti në Prizren: Punësimi i të rinjve, fokusi kryesor i qeverisjes së LDK-së



PRIZREN, 19 JANAR (ER) - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, të martën ka takuar të rinjtë e LDK-së nga rajoni i Prizrenit, me të cilët ka zhvilluar një bashkëbisedim për sfidat nëpër të cilat të rinjtë po kalojnë. "Problemet e rinisë janë probleme për shoqërinë në përgjithësi dhe qeveria jonë ka ndihmuar për zgjidhjen e këtyre problemeve përmes granteve specifike për të rinjtë dhe të rejtat që u duhen për të filluar një biznes. Kjo gjë është një element shumë i rëndësishëm për

pavarësinë e të rinjve", ka thënë Hoti. Gjatë këtij diskutimi të përbashkët me të rinjtë, kryeministri Hoti theksoi se fokusi kryesor i qeverisjes së LDK-së do të jetë qasja integrale me arsim cilësor, duke i ndihmuar të rinjtë për ngritjen e tyre në karrierë. "Ne do t'u sigurojmë të rinjve tanë arsimim cilësor, të bazuar në dijen e kohës, si dhe orientim profilesh mbi bazën e nevojave të tregut të punës", ka thënë kryeministri Hoti. Ndër të tjera, duke pasur parasysh problemet me të

cilat ballafaqohen të rinjtë, kryeministri Hoti theksoi se qeveria e tij do t'i ndihmojë të rinjtë me programe dhe projekte për fuqizimin, zhvillimin dhe punësimin e të rinjve, fondin financiar për kredidhënie dhe grante për të rinjtë.

Duke folur për pakon për rimëkëmbje ekonomike, ku Qeveria e Kosovës në vitin e kaluar ka ndarë 5 milionë euro për kulturë, rini dhe sport, ai theksoi se këtë vit të rinjtë do të mbështeten edhe me 2.5 milionë euro me pakon e re për rimëkëmbje ekonomike.

## Limaj falënderon familjet e dëshmorëve për mbështetjen

PRISHTINË, 19 JANAR (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, u është drejtuar me një mesazh falënderimi familjeve të dëshmorëve, veteranëve dhe invalidëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të cilët po e mbështesin fuqishëm në projektin e tij për mbrojtjen e vlerave

kombëtare. "Jam tejet i lumtur që ditët e fundit shumë familje atdhetare anekënd vendit po i bashkohen projektit tonë politik për mbrojtjen e vlerave kombëtare. Vlerat kombëtare për mua dhe bashkëpunëtorët e mi janë të shenjta dhe për këtë u jam mirënjohës dhe falënderues

çdo familje, çdo bashkëluftëtarë e qytetari të vendit tim, që janë duke u bërë krah i fuqishëm yni për mbrojtje dhe fuqizim të tyre. I shpreh mirënjohje qytetarëve dh bashkëluftëtarëve dhe familjeve që po i bashkohen projektit tonë", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".



# Shpallen të pafajshëm të akuzuarit në rastin “Veteranët”

Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur të martën vendimin në rastin e njohur si “Veteranët”, duke i liruar nga akuza 12 persona të akuzuar për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Gjykata Themelore në Prishtinë ka njoftuar se ata janë liruar nga akuza pasi që “gjykata nuk ka gjetur prova se të njëjtët kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës”

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 JANAR - Të gjithë të akuzuarit për rastin e njohur në opinion si “Veteranët” janë shpallur të pafajshëm të martën nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Përmes një komunikate Gjykata Themelore në Prishtinë ka njoftuar se ata janë liruar nga akuza pasi që “gjykata nuk ka gjetur prova se të njëjtët kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës”. Prokuroria Speciale e Kosovës në vitin 2018 kishte ngritur aktakuzë, të cilën e kishte dërguar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër 12 të pandehurve, për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Në këtë rast, të akuzuar ishin

ish-kryeministri i Kosovës, Agim Çeku, ish-ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, ish-deputeti Shkumbin Demalilaj, më pas Faik Fazliu, Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaha, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Smajl Elezaj, Fadil Shurdhaj dhe Xhavit Jashari. Edhe avokati Arianit Koci ka thënë se të gjithë personat e përfshirë në këtë rast janë shpallur të pafajshëm dhe janë liruar nga të gjitha aktakuzat. Ata ishin akuzuar për kohën sa ishin pjesë e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Sipas aktakuzës së përgatitur nga ish-prokurori Special, Elez Blakaj, personat e përfshirë akuzohen se prej vitit 2011 deri

në vitin 2017, duke vepruar si anëtarë të Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së UÇK-së, kanë shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, duke tejkaluar kompetencat me dashje dhe duke mos i përmbushur detyrat zyrtare, me qëllim që të përfitojnë personat e tjerë në mënyrë të kundërligjshme. Prokuroria e Shtetit kishte thënë se numri i përfituesve të jashtëligjshëm nga kjo kategori mund të jetë deri në 19 mijë persona. Ish-kryeministri i Kosovës, Agim Çeku, ka dhënë një

prononcim para mediave, pas vendimit të gjykatës që e liroi atë nga akuza për keqpërdorim të detyrës, përkatësisht mundësimin e pensioneve për veteranë të rrejshëm. “Për mua dhe anëtarët e tjerë të komisionit për verifikimin e veteranëve është një aktgjykim i drejtë dhe i pritur. Gjatë tërë kohës që nga fillimi e kam ndier veten të pafajshëm, absolutisht të pafajshëm dhe këtë e dëshmuam gjatë këtij procesi. Ndiem mirë se u vërtetuan gjitha ato që i kam thënë edhe para fillimit të procesit edhe gjatë procesit”, ka thënë Çeku. Edhe i akuzuari tjetër në këtë rast, ish-deputeti Shkumbin

Demalilaj, së pari ka falënderuar avokatin e tij mbrojtës duke shtuar se pafajësia e tij ka qenë e dëshmuar nga vetë ai. “Unë sot me pafajësinë time që e bëri gjykata e falënderoj fillimisht avokatin tim mbrojtës, zotin Kocin, që ka qenë pranë meje gjatë kësaj periudhe. Pafajësia ime ka qenë e dëshmuar nga vetë unë për shkak se unë i njoh procedurat ligjore. Tri legjislatura jam deputet i Kuvendit dhe fillimisht prej fillimit u kam treguar mediave dhe të gjithë qytetarëve se unë nuk bëj shkelje të ligjit”, ka thënë Demalilaj, duke shtuar se pafajësinë ua dedikon të gjithë bashkëluftetarëve.

## KDI-ja reagon për procesin e tenderimit për spitalin e Podujevës



PRISHTINË, 19 JANAR (ER) - Në dhjetor 2020 Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) kishte shpallur tenderin për Ndërtimin e Spitalit në Podujevë me vlerë të parashikuar 9,159,833.81 euro. Ndonëse në Ligjin për buxhetin 2021 nuk figuron linjë buxhetore për këtë projekt, SHSKUK ka vazhduar zhvillimin e aktivitetit të prokurimit, duke e bërë hapjen

e ofertave më 18 janar 2020. “Në këto rrethana vazhdimi i kësaj procedure të prokurimit pa mjete buxhetore të alokuara nuk është në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon këtë çështje. Rikujtojmë që sipas nenit 9 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), nëse Autoriteti Kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore, atëherë zyrtari kryesor financiar, në pajtim me dispozitat e aplikueshme të

Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullat Financiare, do të sigurojë nëse janë ndarë mjete të mjaftueshme financiare për prokurimin përkatës në shumë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mund të dalin si rezultat i prokurimit në fjalë gjatë vitit aktual fiskal”, është thënë në reagimin e KDI-së. Në reagim theksohet se pasi që

mjetet financiare nuk janë të parapara në buxhetin 2021 dhe është duke vazhduar ky proces tenderues, ShSKUK-ja rrezikon të hyjë në obligime financiare ndaj operatorëve ekonomikë pasi që nuk kanë në dispozicion shumën e caktuar për këtë projekt. KDI-ja ka rekomanduar që ShSKUK-ja ta anulojë këtë aktivitet të prokurimit duke qenë se i njëjti nuk është duke u zbatuar sipas dispozitave

ligjore. Përderisa për këtë projekt në buxhetin e vitit 2020 ishin ndarë 150 000.00 euro, KDI-ja kishte gjetur se në Projektligjin për Buxhetin e vitit 2021 ky projekt nuk kishte linjë buxhetore. Për këtë, më 15 dhjetor 2020, KDI-ja ka bërë thirrje që ky “lëshim” të adresohet gjatë amendamentimit të Projektligjit për Buxhet 2021, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

# Nitaj takon menaxhmentin e 'Trepçës' dhe Telekomit, diskutojnë për gjendjen në këto ndërmarrje



Ministri në detyrë i Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Muharrem Nitaj, ka pritur të martën në takim anëtarët e bordit dhe menaxhmentit të "Trepçës". Nitaj po të martën ka pritur në takim edhe menaxhmentin e Telekomit. Gjatë takimit ministri Nitaj është njoftuar për gjendjen në Telekom. Ai u ka thënë të pranishmëve se, përkundër se kjo ndërmarrje ka filluar të punojë me fitime, gjendja vazhdon të mbetet e vështirë

**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 19 JANAR (ER)** - Ministri në detyrë i Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Muharrem Nitaj, ka pritur të martën në takim anëtarët e bordit dhe menaxhmentit të Trepçës. Gjatë takimit është

diskutuar për problemet me të cilat po përballet ndërmarrja Trepça për shlyerjen e borxheve që ka ndaj operatorëve ekonomikë, në veçanti për borxhin që ka ndaj KEDS-it për energjinë e shpenzuar. Ministri Nitaj ka kërkuar nga bordi dhe menaxhmenti i "Trepçës" që të

reduktohen sa më shumë që është e mundur shpenzimet. Po ashtu, u kërkuar të shikohet mundësia e riprogramimit të borxheve. Ministri u njoftua edhe për goditjen ekonomike që ka marrë "Trepça" nga kriza ekonomike e shkaktuar si pasojë e pandemisë, pasi ka

pasur ulje të madhe të çmimit të shitjes së koncentratit mineral. Ministri Nitaj ka kërkuar që të shikohen të gjitha mundësitë që ndërmarrja "Trepça" të fillojë të operojë me fitime. Nitaj, po ashtu, të martën ka pritur në takim menaxhmentin e Telekomit. Gjatë takimit ministri Nitaj është njoftuar për gjendjen në Telekom. Ai u ka thënë të pranishmëve se, përkundër se kjo ndërmarrje ka filluar të punojë me fitime, gjendja vazhdon të mbetet e vështirë, pasi një pjesë e të hyrave duhet të paguhet çdo muaj ndaj "Dardafon"-it për

shlyerje të borxhit. Po ashtu, ministri Nitaj u njoftua se stabiliteti i punës së Telekomit mund të dëmtohet nga teknologjia e vjetër me të cilën operon dhe mungesa e mirëmbajtjes së kësaj teknike. "Lajm pozitiv është se pas një kohe të gjatë, Telekomit ka filluar të operojë me fitime. Në takim u kërkuar shikimi i mundësisë së riprogramimit të borxheve që Telekomit ka ndaj 'Dardafon'-it dhe ndërmarrjeve të tjera dhe uljes së shpenzimeve që Telekomit të funksionojë si një ndërmarrje fitimprurëse", ka njoftuar Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

## Abrashi prezanton projekt të ri në lagjen "Dardania" në Fushë-Kosovë

**PRISHTINË, 19 JANAR (ER)** - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, bashkë me nënkryetarin e Komunës së Fushë-Kosovës, Fadil Krasniqi, kanë vizituar lagjen "Dardania", ku është projektuar të ndërtohet një rrethrotullim.

Ministri tha se rrethrotullimi do të bëhet për ta shkarkuar lagjen "Dardania" të Fushë-Kosovës për shkak të rritjes së fluksit të veturave. "Ky rrethrotullim do ta zgjidhë problemin edhe për banorët e Fushë-Kosovës, por edhe për bizneset që gjenden në këtë pjesë. Nevoja për ta ndërtuar këtë rrethrotullim ka lindur për shkak të rritjes së numrit të veturave që kalojnë

nëpër këtë rrugë", ka thënë Abrashi.

Ai ka bërë me dije se kjo do të jetë zgjidhje afatgjatë që do ta lehtësojë edhe komunikacionin. "Janë mbi 54 mijë vetura që kalojnë nëpër këtë rrugë brenda ditës, në rrugën N9, dhe ka qenë e domosdoshme që të ndërtohet një rrethrotullim", ka thënë Abrashi.

Projekti ideor është punuar në tri variante nga kompania projektuese e kontraktuar nga Ministria e Infrastrukturës. Ndërsa nënkryetari i Fushë-Kosovës, Fadil Krasniqi, tha se projekti do të ketë impakt të madh në Fushë-Kosovë, veçanërisht në lagjen "Dardania".







## Bahtiri nënshkruan marrëveshje me Fondacionin e Mileniumit të Kosovës

MITROVICË, 19 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, së bashku me nënkryetarin Faruk Mujka, janë mirëpritur në takim nga drejtori ekzekutiv i Fondacionit të Mileniumit të Kosovës (MFK), Petrit Selimi, me të cilin kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me qëllim implementimin e projektit për riparimet për eficiencë të energjisë në Mitrovicë. Përmes këtij memorandumit të mirëkuptimit është formalizuar bashkëpunimi mes këtyre dy palëve me qëllim t'i implementojë suksesshëm aktivitetet në kuadër të projektit AER, si dhe t'i mbështesë përpjekjet e vazhdueshme të

MFK-së drejt përmirësimit të masave për eficiencë të energjisë në sektorin rezidencial. Ky investim do të ndihmojë për promovimin e masave të eficiencës së energjisë, duke zvogëluar kështu konsumin e energjisë për ngrohje, si dhe duke ngritur vetëdijen e konsumatorëve për përfitime afatgjata të masave të eficiencës së energjisë. Banesat e përzgjedhura për renovim janë në rrugën e Kovaçëve tri banesa, dhe një në rrugën "Mbretëresha Teutë". Ky projekt do të implementohet në fund të marsit, me mundësi të vazhdimin në banesat e tjera kolektive të ndërtuara para luftës dhe ato që kanë nevojë për renovime.



## Ndihmohen 400 familje skamnore në Skenderaj



SKENDERAJ, 19 JANAR (ER) - Komuna e Skenderajt, në bashkëpunim me organizatën "Qatar Charity", të martën kanë bërë shpërndarjen e pakove për 400 familje në nevojë. Në kuadër të këtyre pakove ushqimore përfshihen edhe gjësende dimërore për familjet

në asistencë sociale të kësaj komune. Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, në emër të qytetarëve të Skenderajt, ka shprehur mirënjohje për organizatën "Qatar Charity", për përkrahjen e dhënë në vazhdimësi për

familjet në nevojë të komunës. Po në këtë ditë, bamirësi Nebih Loshi nga fshati Pemishtë, u ka dalë në ndihmë stafit mjekësor në QKMF-në e Skenderajt, duke dhuruar 100 palë veshje mbrojtëse ndaj virusit Covid-19 si dhe 1 000 kilogramë miell për familjet në nevojë.

## Nënshkruhet marrëveshja për funksionalizimin e një qendre edukative në Gjakovë

GJAKOVË, 19 JANAR (ER) - Komuna e Gjakovës, e përfaqësuar nga kryetari Ardian Gjini, si dhe "Caritas Kosova", e përfaqësuar nga Don Viktor Sopi, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi për funksionimin e Qendrës Sociale Edukative në lagjen "Ali Ibra". Në këtë qendër do të zhvillohen aktivitete për edukimin e fëmijëve

parashkollorë nga mosha 3-6 vjeç, programi "ndihmë në detyrat e shtëpisë", ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuadër të projektit "Home Care", asistencë sociale për familjet në nevojë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe aktivitete psiko-sociale, kulturore dhe sportive. Ky projekt ka kosto 42 610 80 euro dhe do të zhvillohet deri në dhjetor 2021.



## Bulliçi takohet me përfaqësuesit e organizatës 'Llampa Innovation Center'

PODUJEVË, 19 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliçi, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e organizatës joqeveritare "Llampa Innovation Center", Blerina Zejnullahu, Gëzim Zejnullahu dhe Valon Shabani, me të cilët ka biseduar për aktivitetet dhe format e bashkëpunimit. Përfaqësuesit e "Llampa Innovation Center" e kanë njoftuar kryetarin Bulliçi për

angazhimet e tyre dhe projektet në të cilat janë të fokusuar si organizatë, për të cilat kanë thënë se targetojnë kryesisht të rinjtë dhe aktivitetet e tyre kryesore kanë të bëjnë me ofrimin e trajnimeve në zhvillimin e shkathtësive dhe gjuhë programuese. Për zhvillimin e tyre dhe rritjen e gamës së programeve dhe aktiviteteve që ofrojnë, përfaqësuesit e kësaj organizate kërkuan nga kryetari Bulliçi ndihmë për të

siguruar një lokacion të përshtatshëm. Ndërsa kryetari Bulliçi ka përgëzuar të rinjtë e kësaj qendre për punën dhe aktivitetet e tyre, ndërsa u ka premtuar që në afat sa më të shkurtër kohor do të angazhohet për sigurimin e një lokacioni të përshtatshëm për ta. Po ashtu, Bulliçi u ka premtuar mbështetje të komunës që drejton edhe për realizimin e përbashkët të programeve me interes për të rinjtë llapjanë.



Aziz Kelmendi dhe enigma e vrasjeve pa luftë në kohë robërie (5)

# Bastisja e shtëpisë dhe ceremonia e varrimit nën vrojtimin e rreptë të autoriteteve jugosllave




Lulzim SAHITI

Pa asnjë paralajmërim, në mëngjesin e 3 shtatorit të vitit 1987, rreth orës 8:00 forca të mëdha policore kishin mësyre shtëpinë e familjes së Aziz Kelmendit. Ato e rrethojnë shtëpinë e tij në të katër anët, madje kishin hyrë edhe në dy oborre të fqinjëve të familjes Kelmendi. Disa ishin vendosur në rrugën kryesore dhe një pjesë e tyre në rrugicën përballë. Pak pa ardhur policia, vëllai i Azizit, Isaku, kishte shkuar në Qendrën Arsimore të drejtimeve teknike në Prizren, kurse motra e tij, Melihatja, në Qendrën Arsimore "Dimitrie Tucoviq". Bastisja e shtëpisë së tyre kishte vazhduar deri rreth orës 10:00, ku me vete kishin marrë vëllanë e madh të Azizit, Hajrizin, po edhe Idrizin. Në shtëpi kishte mbetur vetëm gruaja e Hajrizit, Miradija, së bashku me dy vajzat (Nora dhe Majlinda) si dhe Besimin, vëllanë e vogël të Azizit. Shtëpia ishte bërë e tëra rrëmujë, nuk kishin lënë asnjë skutë pa kontrolluar. Para deryve të oborrit kishte vazhduar të qëndronte për një kohë të shkurtër një patrullë e policisë. Ndërkohë nga shkolla vijnë Melihatja dhe Isaku, mirëpo askush asgjë nuk dinte se çfarë ka ndodhur dhe çka është duke ndodhur. Pas intervistimit në SPB të Prizrenit ishte kthyer në shtëpi Idrizi, kurse vetëm pak kohë pas tij ishte liruar edhe Hajrizi. Ata kishin treguar në

familje se e tërë biseda në SPB ishte zhvilluar rreth Azizit, por asnjë informatë atyre nuk u kishin dhënë se çfarë ka ndodhur. Pak pas orës 15:00 kishte rënë zilja dhe te dyert kishte dalë Hajrizi. Kishte qenë një kushëri i tyre i cili kishte dëgjuar lajmet e Radio Prishtinës dhe e kishte njoftuar për lajmin e parë zyrtar që kishte dëgjuar lidhur me ngjarjen e Paraqinit. Pas këtij lajmi të transmetuar nga Radio Prishtina, për ta ndarë dhimbjen me familjen Kelmendi kishte shkuar menjëherë xhaxhai i tyre, Sylja, më pastaj një nga një shkojnë edhe fqinjët dhe dashamirët e tjerë.

Atë ditë nga Paraqini dy eprorë ushtarakë shoqërojnë dy prindërit e Azizit deri në shtëpi, në Dushanovë. Njëri oficer qëndronte ulur para me Sadikun, kurse tjetri prapa me bashkëshorten e tij. Të katërit udhëtonin me veturën e Sadikut, mirëpo gjatë gjithë rrugës nuk kishin komunikuar ndërmjet vete fare. Ata rreth orës 17:00 kishin mbërritur në shtëpi. Me të hapur dyert e oborrit nga Sadiku, Melihatja e kishte parë nga dritarja dhe kishte bërë titur "Baba!" Të gjithë në familje ishin stepur. Vërtet kjo ishte një befasi sepse askush nuk e kishte menduar ardhjen e tyre në këtë ditë kritike. Në mbrëmje familjen Kelmendi për ngushëllime e kishte vizituar edhe profesor Xhamajli Berisha. Siç është tradita, familja Kelmendi kishte hapur të pame për ngushëllime duke vendosur karrigen jashtë oborrit para portës hyrëse. Asokohe e pamja ishte shtatë ditë, mirëpo para kohe familja detyrohet të ndërpresë atë duke hequr karrigen, meqë organet e sigurimit jugosllav e detyrojnë. Më 4 shtator 1987, pas



Studenti i drejtësisë, Aziz Kelmendi (1967-1987)

përfundimit të obduksionit në Spitalin Ushtarak në Nish, nën përcjelljen e organeve ushtarake, e nisin kufomën e Azizit për në Prizren. Arkivoli ishte i mbyllur hermetikisht dhe para se t'i jepej lamtumira e fundit të ndjerit, familja kishte tentuar ta bënte hapjen e arkivolit, por strukturat politike të asaj kohe që vepronin në kuadër të Bashkësisë Lokale në Dushanovë nuk kishin lejuar. Mirëpo, për ta parë fytyrën e të ndjerit ishte mundësia ngaqë arkivoli kishte një xham të vogël nga qelqi. Pushteti i asaj kohe, po ashtu, i kishte ndaluar njerëzit të dilnin në varrim, mirëpo me gjithë vështirësitë e kohës kishin marrë pjesë rreth 50 veta që ishin kryesisht miq dhe anëtarë të familjes Kelmendi.

Nuk kishte zgjatur shumë kohë dhe nga organizatat e atëhershme shoqërore-politike u mor vendimi që familja e Aziz Kelmendit të lëçitet dhe bojkotohet plotësisht duke filluar nga Bashkësia Lokale e fshatit Dushanovë dhe kudo tjetër ishte propozuar që familja Kelmendi të mbetet e vetmuar.

Madje kryesia e KK e LSHL e LNC-së e Prizrenit shkoi aq larg saqë më 9 shtator 1987 ka marrë iniciativë që familja e Aziz Kelmendit të dëbohet nga Dushanovë e Prizrenit dhe të kthehet në fshatin nga ka ardhur. Në varrim pati më shumë milicë, inspektorë të sigurimit shtetëror, oficerë ushtarakë sesa qytetarë. Atë ditë djali i tezës së Azizit, Ibrahim Bungu, gjatë ceremonisë së varrimit kishte identifikuar Sinisha Didiqin nga Shtimja, inspektor i lartë i Sigurimit Shtetëror në Prishtinë. Përndryshe, ky ishte i biri i Kosta Didiqit që udhëhiqte Sekretariatit e Mbrojtjes Popullore në Ferizaj. Ai me bashkëpunëtorët e vet vrojtonte me kujdes pjesëmarrësit e varrimit. Propaganda jugosllave e bëri të veten duke i frikësuar qytetarët për të mos marrë pjesë në varrim.

Operativistët serbë e shqiptarë nuk qëndronin duarkryq as pas përfundimit të ceremonisë mortore. Vazhduan ndjekjen e pjesëmarrësve që kishin marrë pjesë në varrim. Më 6 shtator 1987 inspektori i Sigurimit Shtetëror, Ramiz Hoxha, kishte shkuar te shtëpia e Ibrahim Bungut në Shtime dhe e kishte marrë atë me vete. Mandej e dërgon në Sekretariatit për Punë të Brendshme në Ferizaj, ku së bashku me inspektorin tjetër, Nezir Sherifi, e interviston në detaje për Azizin duke e pyetur për kohën sa kishte banuar në familjen e tij, për pjesëmarrje në varrimin etj.

## Arrestimi i Sadik Kelmendit dhe bastisja e shtëpisë së tij për herë të dytë

Autoritetet jugosllave, në orët e hershme të mëngjesit, më 5 shtator 1987 e paraburgosin Sadik Kelmendin, të cilin e dërgojnë në Sekretariatit për Punë të Brendshme në Prizren. Diku në mesditë, Njësia Speciale e Policisë ka bastisur sërish shtëpinë e familjes së Aziz Kelmendit. Në secilën derë e dritare të shtëpisë kishin drejtuar nga një armë. Me këtë rast, gjatë bastisjes policia kishte kontrolluar nënë Salën, tek e cila kishte gjetur një revole të tipit CZ me kalibër 7.65 mm, me dy karikatorë e gjashtë fishekë, armë kjo e bashkëshortit të saj. Atë ditë policia kishte marrë të gjitha fotografitë, albumet, librat, fletoret, shënimet dhe gjësendet e tjera të Azizit. Më 7 shtator 1987, Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prizren, Sadik


Kelmendin (47-vjeçar), e dënuan me 60 ditë burg dhe menjëherë e dërgojnë në vuajtje të dënimit në burgun e Nishit. Atje e mbajnë në burg një muaj dhe sërish e kthejnë në Burgun e Prizrenit, ku përfundon vuajtjen e dënimit të mbetur prej një muaji. Më 8 shtator 1987 merren në bisedë informative të gjithë anëtarët e moshës madhore të familjes Kelmendi. Nëna e Azizit, Sala dhe djemtë e saj: Hajrizi, Idrizi dhe Isaku, të cilët i morën në pyetje në Sekretariatit për Punë të Brendshme në Prizren. Ndërsa motrën e tyre pesëmbëdhjetë-vjeçare, Melihatën, e përjashtuan nga Qendra e Shkollimit të Mesëm "Dimitrie Tucoviq" në Prizren. Gjithashtu, ajo me vendimin e konferencës shkollore të Lidhjes së Rinisë Socialiste të qendrës së shkollës së mesme u përjashtua edhe nga organizata e rinisë. Pushteti i atëhershëm shkoi aq larg saqë për familjen Kelmendi në Dushanovë, kërkoi që të gjithë fshatarët ta izolonin familjen e tyre.

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prizren më 8 shtator 1987 kishte kërkuar nga SPB në Prizren për zgjerimin e procedurës kundër nënës së Azizit, Salë Kelmendi, për bashkëpjesëmarrje dhe fshehje të armës së zjarrit. Nuk kishte shkuar shumë gjatë dhe Gjykata për Kundërvajtje në Prizren, Salë Kelmendin e dënonte me 60 ditë burg, e cila dënimin e kishte vuajtur në Burgun e Mitrovicës. Pas rastit të Paraqinit, filloi shqyrtimi i përshtatshmërisë ideopolitike të anëtarëve të ngushtë të familjes së Aziz Kelmendit. Për Hazir Kelmendin është kërkuar të revokohet nga funksioni i delegatit në Dhomën Shoqërore-Politike të Kuvendit të Komunës së Lipjanit ngase ishte xhaxha i Azizit.

Sistemi i atëhershëm jugosllav nën trysninë e Serbisë bënte përpjekje të vazhdueshme ta shkatërrojë familjen e Aziz Kelmendit duke u shkaktuar atyre një varg traumash të rënda psikike e fizike. Gjithashtu, bënte fushatë të egër me shkrime të ulëta denigruese e fyese kundër familjes Kelmendi dhe mbarë popullit shqiptar në Jugosllavi. E vetmja ishte kryesia e Rinisë Socialiste e Sllovenisë, e cila në atë kohë, më 14 shtator 1987, në Lubjanë kishte reaguar duke kërkuar që të themelohet një komision i veçantë për studimin e rastit të Paraqinit si dhe kishte dënuar fushatën kundër familjes Kelmendi dhe mbarë kombësisë shqiptare në Jugosllavi. (Vijon)



Varri i dëshmorit Aziz Kelmendi në Arbanë të Prizrenit



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Sot derbi Peja - Rahoveci, nesër Ylli - Bashkimi



Prishtinë, 19 janar - Në mesjavë zhvillohet xhiroja e 16-të në Superligën e Kosovës në basketboll. Takimi i parë do të zhvillohet ndërmjet Vëllaznimit dhe Ponte Prizrenit. Kuqezinjtë kanë katër fitore dhe 11 humbje, kurse prizrenasit dhjetë fitore dhe pesë humbje dhe do të mundohen t'u kthehen fitoreve pas humbjes nga Golden Eagle Ylli. Takim interesant shihet ndërmjet Pejës dhe Rahovecit. Të dyja skuadrat janë në formë të mirë dhe përballja në 'Karagaçi' shihet si shumë interesante. Pejanët kanë dhjetë

fitore dhe pesë humbje, kurse Vreshtarët 12 fitore dhe tri humbje, duke u renditur në vendin e parë. Të enjten do të përballen rivalët e vjetër, por që gjenden në pjesën e poshtme të tabelës, Sigal Prishtina dhe Trepça. "Bardhekaltrit" kanë katër fitore dhe 11 humbje, kurse mitrovicasit tri fitore dhe 12 humbje. "Bardhekaltrit" renditen në vendin e gjashtë me pikë të njëjta me Vëllaznimit, që renditet i shtati, kurse "Xehetarët" janë në vendin e tetë. Takimi i fundit është ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Bashkimit. Ylli në fundjavë mundi

Ponte Prizrenin, kurse Bashkimi pësoi nga Trepça. Therandasit kanë nëntë fitore dhe gjashtë humbje, ndërsa prizrenasit tetë fitore dhe shtatë humbje.

### SUPERLIGA - Java 16

**Të mërkurën takohen:**  
15:00 Vëllaznimi - Ponte Prizreni  
17:00 Peja - Rahoveci

**Të enjten takohen:**  
15:00 Sigal Prishtina - Trepça  
17:00 Golden Eagle Ylli - Bashkimi

### SHKURT

#### Llapi mposhti në miqësore Diyarbairsporin

Skuadra e Llapit është duke vijuar përgatitjet në Antalia të Turqisë për fazën përgatitore para fillimit të kampionatit. Ekipi i drejtuar nga trajneri Tahir Batatina sot e ka zhvilluar miqësoren e radhës ku është takuar me skuadrën e Diyarbairsporit. Llapjanët triumfuan në këtë miqësore me rezultat minimal 1-0, kurse golin e vetëm e shënoi Mentor Zhdrella. Ditë më parë, Llapi luajti baras 1-1 me Tuzlasporin.

#### Përforcohet KB Trepça

Basketbollisti nga Mali i Zi, Ivan Koljeviq, është përforcimi i radhës i Trepçës, ka njoftuar klubi mitrovicas në "Facebook". Koljeviq vjen te Trepça pas një karriere të madhe të kaluar tek ekipet si Olympiacos, Bilbao Basket, Lietuvos Rytas. Ai te Trepça ka kaluar nga Zeta e Malit të Zi. Fundori 36-vjeçar për Zetën këtë edicion ka luajtur me një mesatare prej 23.9 pikëve e 8.6 asistimeve për ndeshje. Ai është në krye të listës së asistuesve më të mirë të ligës së Malit të Zi.

#### Kloppi: Shaqiri është në formë të mirë

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka lavdëruar punën e sulmuesit shqiptar Xherdan Shaqiri. Futbollisti shqiptar ishte në formacionin bazë kundër Manchester Unitedit duke zhvilluar 76 minuta pastaj u zëvendësua me Curtis Jones. "Shaqiri është vërtet në formë të mirë. Ndoshta mund të luante edhe pak më shumë, mirëpo nuk isha i sigurt. Ishte kohë e gjatë që nuk ka luajtur nga fillimi, por ishte vërtet i mirë. Shaqiri ishte aty dhe ndihmoi me të madhe", ka thënë Shaqiri.

#### Presidenti i Fenerbahçes: Do ta mirëprisnim Muriqin

Presidenti i Fenerbahçes, Ali Koç, ka thënë se skuadra turke do ta mirëpriste rikthimin e Vedat Muriqit nëse futbollisti shqiptar do të vendoste të rikthehet në Turqi. 26-vjeçari nuk ka arritur të dëshmojë në skuadrën e Lazios dhe kanë filluar të qarkullojnë zërat se ai mund të rikthehet në futbollin turk, kurse interesim për shërbimet e tij ka shfaqur edhe Galatasaray. "Nuk e di nëse trajneri ynë apo drejtori sportiv kanë bërë diçka për ta rikthyer Muriqin. Nuk di ndonjë gjë për rikthimin e tij të mundshëm. Si fans i Vedatit, shpresoj që ai t'i shfaqë kualitetet e tij dhe të jetë i lumtur në Lazio. Natyrisht, nëse Vedati dëshiron të rikthehet në Turqi, ne do të ishim të parët që do të reagonim dhe me siguri zgjedhja e tij e parë", ka thënë Koçi.

## Askush pozitiv me Covid në klubin e Dritës

**GJILAN, 19 JANAR** - Kampionia në fuqi dhe liderja aktuale e Superligës, Drita, dje ka kryer testet për Covid-19 dhe në rezultatet e dala sot të gjithë në klubin gjilanas kanë rezultuar negativ. "Klubi jonë

FC Drita ditën e djeshme i ka kryer testet për Covid-19 në prag të udhëtimit për në Antalya të Turqisë ku kemi planifikuar ta vazhdojmë fazën përgatitore. Sot kemi marrë rezultatet ku të gjithë

kanë rezultuar negativë dhe nuk do të kemi asnjë mungesë për shkak të testeve. Edhe një herë shfrytëzojmë rastin që ta falënderojmë stafin e IKShPK-së nga Gjilani dhe qendrën në Prishtinë për

gatishmërinë ndaj klubi tonë", thuhet në njoftimin e Dritës. Drita fazën përgatitore dhe ndeshjen e Superkupës ndaj Prishtinës do t'i zhvillojë në Turqi.



## Mercedesi mendon për zëvendësuesin e Hamiltonit

BERLIN, 19 JANAR - Rinovimi i kontratës në mes të pilotit britanik Lewis Hamilton dhe Mercedes ende nuk po vjen, ndërkohë që botërori i Formulës 1 nis pas dy muajsh. Shtatë herë kampioni i botës është duke u përgatitur për sezonin e ri, por aktualisht

është ende pa një makinë. Palët duan ta vijojnë bashkëpunimin dhe rinovimi duket se mund të ndodhë në çdo çast, por pengesë mbetet rroga e lartë që kërkon Hamiltoni. Ndaj, duke parë këtë situatë disi konfuze, Mercedesi po mendon për një

alternativë tjetër. Sipas mediave britanike, drejtuesit e makinës gjermane kanë kontaktuar me një tjetër pilot anglez, George Russell. Ky i fundit zuri vendin e Hamiltonit (kur u infektua me Covid-19) në garën e Sakhir dhe bëri një paraqitje të mirë.

“Në garën e Sakhirit bëri një paraqitje të mirë edhe pse është ende një pilot i ri. Sa më shumë gara që ata zhvillojnë aq më shumë përvojë fitojnë. Vjet pati disa gara që ishin një leksion i mirë për pilotët e rinj”, ka thënë Toto Wolff, drejtor sportiv i Mercedesit.



## Prishtina mban seancën e parë stërvitore në Antalia

ANTALIA, 19 JANAR - Skuadra e Prishtinës ka mbërritur të martën në Lara të Antalias ku do të qëndrojë për dy javë për fazën e përgatitore të dimrit. Në ekspeditën e Prishtinës janë 23 lojtarë, ndërsa mungojnë për shkaqe dokumentacioni Gauthier Mankenda dhe Otto John, portieri Alban Muçiqi i infektuar me Covid-19 dhe Ermal Vitija i lënduar. Ekipi i Prishtinës në këto përgatitje përbëhet nga portierët Eglant Haxho, Ardit Nika dhe portieri i juniorëve, Fatos Sinani. Ndërsa 20 futbollistët janë: Besnik Krasniqi, Erdin Dushi, Gentjan Muça, Leotrim Bekteshi, Lumbardh Dellova, Gledi Mici, Leonit Abazi, Tun Bardhoku, Behar Maliqi, Lorik Boshnjaku, Valon Pllana, Qendrim Zyba, Sabien Lilaj, Endrit Krasniqi, Mergim Pefqeli, Albin Prapashtica, Enis Gavazaj, Dhurim Zhuri, Alban Shillova dhe Leotrim Kryeziu. “Skuadra në këto dy



javë pritet t'i zhvillojë katër ndeshje. Për shkak të masave të ashpra anti-Covid-19 të ndërmarra nga shteti i Turqisë, me gjithë aranzhimin e ndeshjeve, zyrtarizimi i tyre i plotë bëhet vetëm në ditën e takimit”, thuhet në njoftimin e Prishtinës. Skuadra

kryeqytetase pritet të ndeshet me Dritën më 23 janar në kuadër të Superkupës dhe tri miqësoret e tjera kundër Chayka (Liga e parë Rusi, 26 janar), Orenburg (Liga e parë Rusi, 29 janar) dhe Rukh Lviv (Superliga e Ukrainës, 31 janar).

## Lakersat pësojnë humbje nga Golden State

LOS ANGELES, 19 JANAR - Humbje surprizuese për Los Angeles Lakersin në NBA. Kampionët në fuqi pësuan disfatën e 4-t në këtë sezon pasi u mposhtën në “Staples Center” nga Golden State Warriors me rezultatin e ngushtë 115-113. Stephen Curry fitoi duelin personal me Anthony Davisin dhe LeBron Jamesin pasi me 26 pikë, 1 rebound dhe 7 asistime jo vetëm që ishte basketbollisti me statistikat më të mira mbi parket, por udhëhoqi skuadrën nga San Francisco drejt fitores. Për Lakersin më i miri në këtë sfidë ishte gjermani Denis Schroder me 25 pikë, ndërkohë që Jamesi dhe Davisi së bashku realizuan 36 pikë, ndërsa ish-lojtari i Pelicas spikati edhe 17 topa të rikuperuar poshtë tabelës, të pamjaftueshme për ta evituar humbjen. James Hardeni e ka nisur në mënyrën më të mirë të mundshme aventurën te Brooklyn Netsit. Pas triple-doublet të realizuar në ndeshjen e parë ndaj Orlando Magicut, ish-



lojtari i Houstonit shkëlqeu edhe në suksesin që arriti skuadra njuyorkeze ndaj Milwaukee Bucksit me rezultatin e ngushtë 125-123. Hardeni koleksionoi 34 pikë, 6 rebounde dhe 12 asistime në suksesin e katërt rresht të Brooklynit, ndërkohë një paraqitje e shkëlqyer bëri edhe Kevin Durant, autor i 30 pikëve. Për Bucksin që pësoi humbjen e 5-të në këtë sezon nuk mjaftoi greku

Giannis Antetokounmpo, autor i 34 pikëve, ndërsa i ndihmoi të vetët edhe me 12 rikuperime poshtë tabelës dhe 7 pasime deçizive. Një fitore të thjeshtë mori Toronto Raptorsit përballë Dallas Mavericksit me rezultatin 116-93, ndeshje në të cilën shkëlqeu Kyle Lowry me 23 pikë, 9 rebounde dhe 7 asistime. Nuk pati probleme as Miami Heat për ta mposhtur 113-107 Detroit Pistonsin.

### SHKURT

#### Messi dënohet dy ndeshje

Lionel Messi është dënuar me dy ndeshje nga Komiteti i Konkurrencës i Federatës Spanjolle të Futbollit për kartonin e tij të kuq në finalen e Superkupës së Spanjës, luajtur të dielën e kaluar. Argentinasi do të jetë i padisponueshëm për dy ndeshjet e ardhshme të Barcelonës kundër Cornellas në Copa del Rey dhe Elche në LaLiga. Messi goditi sulmuesin e Bilbaos, Asier Villalibre, në minutën e fundit të kohës shtesë, teksa i shpëtoi një dënimi më të gjatë, vetëm falë raportit të gjyqtarit Gil Manzano, i cili nuk e quajti si një shenjë agresioni. “Pleshti” u ndëshkua për herë të parë me karton të kuq pas 754 ndeshjes.

#### Marcelo mund të transferohet te Monaco

Mbrojtësi brazilian Marcelo nuk është më në planet e Zinedine Zidanes dhe lidhet me një largim nga “Los Blancos” me të përfunduar ky edicion. Por, sipas asaj që raporton AS, Monaco është duke tentuar transferimin e Marcelo qysh në këtë afat kalimtar të janarit. Trajneri francez nuk ka besim më në mbrojtësin brazilian dhe është i gatshëm që ta largojë atë, mirëpo vetëm në verë. Skuadra nga Liga 1 duhet të presë që të përfundojë ky edicion dhe të tentojë për transferimin e tij. Marcelo ka aktualisht edhe 18 muaj kontratë me Real Madridin dhe duket se koha e tij në Madrid ka përfunduar.

#### Nicola, trajneri i ri i Torinos

Do të jetë Davide Nicola, trajneri i ri i Torinos, që do ta zëvendësojë Marco Giampaolon, i cili u shkarkua ditën e djeshme, pas rezultateve negative këtë sezon. Largimi i tij nga klubi “granata” erdhi pas barazimit në shtëpi të Torinos ndaj Spezias. Për sa i përket Nicolës, ai rikthehet te Torino, pas përvojës si futbollist, ku u aktivizua 35 ndeshje gjatë sezonit 2005-2006. Ndërkohë si trajner, 47-vjeçari së fundi drejtoi klubin e Genoas, bëhet fjalë për sezonin 2019-2020. Tekniku italian gjithashtu në të kaluarën ka drejtuar edhe klube të tjera italiane si Udinese, Crotone, Bari dhe Livorno.

#### Zidane nuk jep detaje për transferimin e Mbappes dhe Alabas

Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, është pyetur për futbollistët që Reali mund t'i transferojë. Trajneri francez nuk ka dhënë asnjë detaj rreth transferimit të mundshëm të Kylyan Mbappe (PSG) dhe David Alaba (Bayern Munchen). “Ju dëshironi të më pyesni për lojtarë që nuk i kam në dispozicion por, më falni, fokusi im është te ndeshja e radhës. Si për Mbappen, ashtu edhe për Alaban nuk mund të komentoj”, ka thënë Zidane.

#### Mandzukiqi edhe zyrtarisht i bashkohet Milanit

AC Milani ka njoftuar edhe zyrtarisht se Mario Mandzukiq i është bashkuar klubit në një marrëveshje gjashtëmujore. Milani dhe Mandzukiq kanë arritur marrëveshje për qëndrimin e sulmuesit kroat në San Siro deri në përfundim të këtij sezoni, me mundësi për zgjatjen e marrëveshjes edhe për një vit, njofton klubi i Serisë A. Përfaqësuesi i Kroacisë, Mandzukiq, iu bashkua Milanit si lojtar i lirë. Ish-sulmuesi i Juventusit mbërriti në Milano në fundjavë dhe i kreu testet mjekësore të hënën. “AC Milan ka kënaqësinë ta njoftojë transferimin e Mario Mandzukiqit. Klubi dhe sulmuesi janë pajtuar për një ujdë deri në fund të sezonit aktual me mundësi për zgjatjen e kontratës edhe për një vit”, thuhet në njoftimin e Milanit. Milani, po ashtu, konfirmoi se 34-vjeçari do ta veshë fanellën me numrin 9.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutrašnjih poslova /  
Ministry of Internal Affairs

Ministarstvo unutrašnjih poslova na osnovu Zakona br. 04 / L-076 o policiji i Administrativnog upustva br. 13/2012-MUP o osnivanju, sastavu i procedurama Komisije za viša policijska imenovanja, objavljuje:

## KONKURS

**Naziv posta:** Zamenik generalnog direktora Kosovske policije

Referenca: MUP-ZGDP / 02

**Trajanje:** pet (5) godina sa mogućnoću obnavljanja svakih pet (5) godina od strane organa za imenovanja

**Mesto:** Priština

**Izveštavanje:** Zamenik generalnog direktora izveštava i odgovara direktno generalnom direktoru kosovske policije.

Nivo plate: Prema važećem zakonu

Radno vreme: Puno

Odgovornost izvršnog rukovodstva: Da

### Funkcije i odgovornosti:

1. Obavlja dužnosti i ovlašćenja generalnog direktora u njegovom odsustvu, u nemogućnosti da se pojavi ili na njegov zahtev;
2. Pomaže u obavljanju funkcija generalnog direktora u skladu sa instrukcijama generalnog direktora;
3. Takođe vrši i druge funkcije koje određuje generalni direktor nakon odobrenja od strane ministra;

### Potrebne veštine, iskustvo i drugi atributi:

- Dokazane veštine o strateškom mišljenju, planiranju i implementaciji;
- Veštine za koordinaciju i kontrolu;
- Dokazana sposobnost za analiziranje potreba za obukom, određivanje odgovarajućih rešenja, praćenje i ocenjivanje kvaliteta intervencije;
- Odlične sposobnosti za organizovanje, radeći u okruženju pod pritiskom;
- Dokazane i efikasne veštine u pisanju i usmenoj komunikaciji;
- Pdllične lične menadžerske veštine i veštine pregovaranja;
- Posedovanje veština za timski rad.

### Potrebne kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma sa akreditiranog univerziteta ili diplomu sertifikovanog;
- Kandidat treba da zna jedan od službenih jezika u pisanju i čitanju, a prepoznavanje engleskog jezika je prednost.

### Posebni uslovi:

- Da bude državljanin Republike Kosova;
- Da ne bude osuđen za krivično delo konačnom odlukom, (molimo dostavite sertifikat da niste u istrazi izdat ne više od 6 meseci prije datuma podnošenja zahteva);
- Da ne bude kažnjen za teške disciplinske prekršaje prema disciplinskim propisima policije ili propisima drugih državnih institucija u poslednjih deset (10) godina, što je ekvivalentno krivičnim delima utvrđenim u propisu o disciplini Kosovske policije;
- Imati čin pukovnika, potpukovnika ili poručnika najmanje pet (5) godina;
- Svaki kandidat ne bi trebao imati sukob interesa sa zadatkom ili kao što je predviđeno Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija;
- Svaki kandidat za ovu poziciju podleže proveru sigurnosti prema važećem zakonu;
- Kandidati bi trebali dati pismo od interesa u vezi sa motivima koji su doveli kandidata da se takmiči, kao i njegov CV.

### Način konkurisanja:

Obrasci za konkurisanje se mogu uzeti na recepciji MUP-a u Prištini ili da se izvuku sa web stranice MUP-a gde je i objavljen konkurs, na adresi [www.mpb-rks.org](http://www.mpb-rks.org) i predaju se u Kancelariji za ljudske resurse, ili elektronskom poštom ([ahmet.sh.gashi@rks-gov.net](mailto:ahmet.sh.gashi@rks-gov.net), ili poštom na adresi: Divizija za ljudske resurse, Ul. Luan Haradinaj, b.b. (kod gradskog stadiona) Priština, svakog radnog dana od 8:00 – 16:00.

Konkurs je otvoren 15 dana nakon objavljivanja u dnevnim novinama od 20.01.2021 do 03.02.2021

Za dodatne informacije kontaktirajte g. Ahmet Gashi, br. tel. 038/200 19 548.

Aplikaciji treba priložiti: fotokopiju lične karte, kopije dokumentacije za kvalifikacije osnovnih studija, dokaza vojne čin majora, potpukovnika ili pukovnika za pet godina, Uverenje o licima protiv kojih se vodi krivični postupak i osuđenih od suda, dokazi iz nadležne institucije da nije kažnjen za težeg disciplinskog prekršaja u deset (10) zadnjih godina, izjava od kandidata kojom izjavljuje da ne postoji sukob interesa sa pozicije Zg. direktora Kosovske policije, kao što je predviđeno u Zakonu o policiji i Zakon o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija, izjavu koja mora imati datum i potpis u deklaraciju.

Kandidati koji ulaze u bliskoj selekciji biće obavešteni o intervjuu telefonom ili pismenim putem u zakonskom roku od strane osoblja odeljenja za ljudske resurse.

Kandidati koji poseduju sigurnosni sertifikat pripisuju njegovu kopiju aplikaciji.

Kandidati koji će biti izabrani i pozvani na intervju trebalo bi da daju sve originalne dokumente na uvidu (potvrdu). Zahtjevi poslani nakon poslednjeg datuma objavljivanja oglasa neće biti prihvaćeni. Nepotpuni zahtevi mogu biti odbijeni.

Ministarstvo unutrašnjih poslova služi svim ljudima Kosova. Ona podstiče apliciranje žena i muškaraca, i bez sumnje sve manjinske etnike grupe na Kosovu.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Paviman" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810868531.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.3020/19

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtaren Shpresa Veselaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Kreshnik Zeqiri nga Prishtina, me vendbanim në Itali në qytetin Vazzola, provinca e Treviso, rr. CarVittorio V.TO Num 13/A të cilin e përfaqëson me prokurë Rita Matoshi avokate nga Prishtina; kundër të paditurës Almedina Hyseni nga Prishtina, me vendbanim në Itali, tani me adresë të panjohur, për zgjidhjen e martesës, duke vendosur sipas Propozimit të paditësit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurën, jashtë seancës gjyqësore me datën 21.12.2020 mori këtë:

**AKTVENDIM**

- I-** Të paditurës Almedina Hyseni nga Prishtina, me vendbanim në Itali, tani me adresë të panjohur i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Arlinda Avdimetaj, avokate nga Prishtina, i cili ka për obligim që të paditurën t'a përfaqësoj në procedurën për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim në lëndën C.nr.3020/19.
- II-** Sipas Dispozitës së nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesit e tyre me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se ju ka caktuar kujdestarin.
- III-** Ky aktvendim do të shpallet në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në Tabelën e shpalljeve të gjykatës.

**Arsyetim**

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi me dt. 04.09.2019, kundër të paditurës Almedina Hyseni nga Prishtina, me vendbanim në Itali, tani me adresë të panjohur, për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore me dt. 18.02.2020, në të cilën seancë ka prezantuar përfaqësuesja me prokurë e paditësit, ndërsa për të paditurën askush nuk ka prezantuar në seancë, andaj me qëllim që çështja të mos zvarritet nga ana e të paditurës, paditësi i propozoi gjykatës që të caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, sipas dispozitës së nenit 79.3 të LPK-së, për të paditurën Almedina Hyseni nga Prishtina, me vendbanim në Itali të cilës tani nuk i dihet adresa.

Duke vendosur sipas propozimit të paditësit, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79 par. 3 pika (a) të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurit. Andaj, gjykata vendosi që të paditurës, t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Arlinda

Avdimetaj, avokate nga Prishtina, nga lista e avokatëve të Odës së Avokatëve të Kosovës, i cili do të përfaqësoj interesat e të paditurës në këtë çështje juridiko-civile.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

C. nr. 3020/19 dt. 21.12.2020

Gjyqtarja  
Shpresa Veselaj



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është lejuar ankese.



REPUBLIKA KOSOVO

C. Br. 3020/19

**OSNOVNI SUD U PRIŠTINI - Opšte Odeljenje – Građanska Jedinica**, sa sudijom Špresa Veselaj, u parničnom postupku tužitelja Kreshnik Zečiri iz Prištine, sa adresom stanovanja u Italiji, grad Vazzola, provincija Treviso, ul. "CarVittorio" V.TO br. 13/A, kojeg zastupa sa punomoćjem Rita Matoši, advokat iz Prištine, protiv tužene Almedine Hyseni iz Prištine, nastanjene u Italiji, sada sa nepoznatom adresom, radi raskida braka, odlučujući prema predlogu tužitelja za određenje privremenog zastupnika, van ročišta održanog 21.10.2020. god, donco je sledeće:

**REŠENJE**


- I.** Arljinda Avdimetaj, advokat iz Prištine, određuje se kao privremeni zastupnik tužene Aljmedine Hyseni iz Prištine, nastanjene u Italiji, sada sa nepoznatom adresom, koja ima obavezu da zastupa tuženu u postupku za razvod braka u predmetu C. br. 3020/19.
- II.** Privremeni zastupnik u smislu člana 82. Zakona o Parničnom Postupku (ZPP), ima sva prava i obaveze zakonskog zastupnika, koje on/ona vrši dok se tuženi/a ili njegov/njen ovlašćeni punomoćnik ne pojave pred sudom, odnosno dok organ starateljstva obaveštava sud o određivanju staratelja.
- III.** Ovo Rešenje će se objaviti u zvaničnoj oglasnoj tabli ovog Suda i u Službenom Listu Republike Kosovo.

**Obrazloženje**

Tužitelj je preko svog zastupnika, dana 04.09.2019. godine podneo tužbu u ovom sudu protiv tužene Aljmedine Hyseni iz Prištine, nastanjene u Italiji, sada sa nepoznatom adresom, za razvod braka.

Sud je zakazao pripremno ročište dana 18.02.2020. god., na kojem je ročištu prisustvovala zastupnik tužitelja sa punomoćjem, dok za tuženu niko nije bio prisutan na ročištu da zastupa istu, stoga sa ciljem da se ne razvlači postupak od strane tužene, tužitelj je predložio sudu da odredi privremenog zastupnika, prema odredbi člana 79.3 ZPP-a za tuženu Aljmedina Hyseni iz Prištine, nastanjene u Italiji, sada sa nepoznatom adresom.

Ja, dole potpisana Seniha Krasniqi PhD, Sudski Tumač, ovlašćena od strane Okružnog Suda u Prištini, sa Odlukom 103/2007, ovim potvrđujem tačnost i autentičnost prevoda od albanskog jezika. U prilog tome, ovde stavljam svoj pečat 18.01.2021. godine u Prištini. Prevodilačka kompanija „Prestige“, Ul. Garibaldi, ulaz 5/5, Priština. Kontakt tel.: +383 45 20 21 21, E-mail: perkthimeprestige@gmail.com.



Odlučujući prema predlogu tužioca, sud je utvrdio da su uslovi iz člana 79. st. 3 tačka (a) ZPP-a ispunjeni za određivanje privremenog zastupnika tužene. Stoga je sud odlučio da za privremenog zastupnika tužene određuje Arljindu Avdimetaj, advokatica iz Prištine, sa spiska advokata Advokatske Komore Kosova, koja će zastupati interese tužene u ovom građansko-pravnom predmetu.

Iz gore navedenog, odlučno je kao u izreci ovog Rešenja.

**OSNOVNI SUD U PRIŠTINI**


C. br. 3020/19, dana 21.12.2020. god.

**PRAVNI LEK:**

Protiv ovog rešenja nije dozvoljena posebna žalba.

Sudija  
Špresa Veselaj  
///pečat i potpis//

Ja, dole potpisana Seniha Krasniqi PhD, Sudski Tumač, ovlašćena od strane Okružnog Suda u Prištini, sa Odlukom 103/2007, ovim potvrđujem tačnost i autentičnost prevoda od albanskog jezika. U prilog tome, ovde stavljam svoj pečat 18.01.2021. godine u Prištini. Prevodilačka kompanija „Prestige“, Ul. Garibaldi, ulaz 5/5, Priština. Kontakt tel.: +383 45 20 21 21, E-mail: perkthimeprestige@gmail.com.







REPUBLIC OF KOSOVO

C. no. 3020/19

**BASIC COURT IN PRISTINA - General Department - Civil Division**, with the judge Shpresa Veselaj, in the litigation matter of the plaintiff Kreshnik Zeqiri from Pristina, with a residential address in Italy, city of Vazzola, Treviso province, str. "CarVittorio" V.TO. no. 13/A, represented with a proxy by Rita Matoshi, a lawyer from Pristina, against the respondent Almedina Hyseni from Pristina, residing in Italy, now with an unknown address, for the dissolution of the marriage, deciding on the plaintiff's proposal for the appointment of the temporary representative, outside the hearing session held on 21.10.2020 took the following:

**RULING**


- I. Arlinda Avdimetaj, a lawyer from Pristina is appointed as a temporary representative for the respondent Almedina Hyseni from Pristina, residing in Italy, now with an unknown address, who has the obligation to represent the respondent in the procedure for the dissolution of the marriage by divorce in the case C. no. 3020/19.
- II. Temporary representative in terms of Article 82 of the Law of Contentious Procedure (LCP), has all the rights and obligations of the legal representative, which he/she exercises until the respondent or his/her authorized proxy appears before the court, respectively, until the guardianship body informs the court of the appointment of a custodian.
- III. This Ruling shall be published in the official announcement board of this Court and the Official Gazette of the Republic of Kosovo.

**Reasoning**

The plaintiff, through his representative, on 04.09.2019 has filed a lawsuit with this court against the respondent Almedina Hyseni from Pristina, residing in Italy, now with an unknown address, for the dissolution of the marriage by divorce.

The court has scheduled the preparatory hearing session on 18.02.2020, in which hearing session was present the plaintiff's representative with a proxy, while for the respondent no one was present in the hearing session to represent the same, therefore in order for the case not to be prolonged by the respondent, the plaintiff proposed to the court to appoint a temporary representative, according to the provision of the Article 79.3 of the LCP for the respondent Almedina Hyseni from Pristina, residing in Italy, now with an unknown address.

I, the undersigned Seniha Krasniqi PhD, Sworn Translator-Interpreter licensed by the District Court in Pristina, with Decision No. 103/2007, do hereby certify that the foregoing is an accurate translation from the Albanian language. In witness whereof, I have hereunto set my Hand and affixed my seal this January 18, 2021 in Pristina. Translation company "Prestige", Str. Garibaldi, entrance 5/5, Pristina. Tel.: +383 45 20 21 21, E-mail: perkthimeprestige@gmail.com



Deciding on the plaintiff's proposal, the court found that the conditions of Article 79 par. 3 item (a) of the LCP were met, for the appointment of the temporary representative for the respondent. Therefore, the court decided to appoint as the temporary representative for the respondent Arlinda Avdimetaj, a lawyer from Pristina, from the list of lawyers of the Kosovo Bar Association, who will represent the interests of the respondent in this civil-legal case.

From that set out above, it was decided as in the enacting clause of the Ruling.

BASIC COURT IN PRISTINA

C. no. 3020/19, date 21.12.2020

Judge:

Shpresa Veselaj

///stamp and signature///

**LEGAL REMEDY:**

No special appeal is allowed against this Ruling.

## Sot bëhen 22 vite nga rënia e Heroit të Kombit

**Afrim Hajrizi**

Sot është një ditë shumë e veçantë për ne dhe për të gjithë kombin tonë. Sot e përkujtojmë Heroin e Kombit të ndjerë Afrim Hajrizi i cili dha jetën e tij që ne ta gëzojmë lirinë ku e jetojmë edhe sot. Në përkujtim marrin pjesë: vëllezërit Zeneli, Hysniu, djali Artani, Qemaili, Keqa, Gazmendi, Labinoti, Remi, Kastrioti dhe Afrimi dhe mbarë mbesat dhe nipërit nga diaspora.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

I, the undersigned Seniha Krasniqi PhD, Sworn Translator-Interpreter licensed by the District Court in Pristina, with Decision No. 103/2007, do hereby certify that the foregoing is an accurate translation from the Albanian language. In witness whereof, I have hereunto set my Hand and affixed my seal this January 18, 2021 in Pristina. Translation company "Prestige", Str. Garibaldi, entrance 5/5, Pristina. Tel.: +383 45 20 21 21, E-mail: perkthimeprestige@gmail.com



Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kiesłowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kiesłowski, i ndërthurur me një egzjegzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlihd temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kiesłowski, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kiesłowski dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLOWSKI

**AGRON SHALA**

**DEKALOGU**

nga Moisiu deri te Kiesłowski

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.

4.99 €



Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

**Daut Dauti**  
**NJË PALË KËPUCË NË BERLIN**

novelë







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

